UDHËZIM
Nr. 9, datë 25.2.2015

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 404, DATË 20.6.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE"

Mbështetur në pikën 11 të vendimit nr. 404, datë 20.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse",

UDHËZOJ:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj.

4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj.

6. Kompensimi për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse është një pagesë mujore e cila llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij udhëzimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike", të ndryshuar.

8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, individët, së bashku me deklaratën duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e nënshkruar të kartës së identitetit;

b) Certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes;

c) Kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;

ç) Kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila vërteton që nuk ka detyrime të prapambetura;

d) Kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të vendimit të KMCAP/KMPV.

dh) Kontratën e qirasë të lidhur sipas nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

kreu VI “Qiraja”, e cila duhet të përmbajë edhe numrin e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike dhe kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse.

9. Njësitë e qeverisjes vendore shpërndajnë çdo muaj pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose "Posta Shqiptare" sh.a.

10. Administratori shoqëror harton kërkesën për fonde për masën e financimit të kompensimit financiar të faturës së energjisë elektrike dhe faturës së telefonisë fikse dhe e bën pjesë të kërkesës së planifikimit të fondeve për aftësinë e kufizuar çdo dy muaj dhe e paraqesin pranë zyrës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj